



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.90 dt.05.06.1998

**MBI
SHQYRTIMIN E ANKESAVE PER DHENIE TE LEJES SE NDERTIMEVE
NGA K.RR.T.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.05.06.1998, pasi shqyrton shkresat e ardhura nga Prefektura e Tiranës Nr.2792 – 2481, dt.3-16.04.1998, si dhe ankesa të qytetarëve, duke u mbështetur në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, si dhe në ligjin Nr.8015, dt.19.10.1995 “Për disa ndryshime”, në ligjin Nr.7693, dt.26.04.1993 “Për urbanistikën” :

VENDOSI

1. Ankesa nga Prefektura me shkresën Nr.455, dt.27.03.1998, e konsideron lejen e ndërtimit midis pallateve Nr.54-56 në Rr.”Bardhyl”, në kundërshtim me ligjin.
Këshilli Bashkiak e gjen lejen e dhënë nga K.RR.T. të rregullt në përputhje me ligjin për urbanistikën.
2. Ankesa nga Prefektura lidhur me lejen e ndërtimit Nr.234, për familjen Koka, nuk shpjegon arsyt pse e konsideron këtë leje në kundërshtim me ligjin “Për urbanistikën”, prandaj për të sqaruar çështjen, Prefektura duhet të dërgojë edhe ankesën e të interesuarit.
3. Ankesa e qytetarit Zef Ashta, lidhet me çështje të pronësisë, të cilat nuk janë në kompetenca të këtij Këshilli.

4. Ankesa e qytetarit Azhenda Bajraktari, lidhet me kërkesën për të ndërtuar në kollonadën e godinës përbri Bankës Kombëtare. Vendimi i K.RR.T. për të mos lejuar këtë ndërtim është i drejtë.
5. Qytetari Abdurrahmi Keleshi ankohet pse si jepet leja e ndërtimit, duke pretenduar se ka bërë meremetime. Këshilli Bashkiak vendosi të shihet në vend nga Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve.
6. Qytetari Bardhyl Tasi kërkon të ndërtojë mbi një truall, i cili në planin rregullues parashihet të jetë pjesë rruge. Refuzimi i K.RR.T. është i drejtë.
7. Qytetari Muharrem Kushe kërkon leje ndërtimi për ndërtesë 6 katëshe (pranë kinema “17 Nëntori”), por ka probleme me banorët e pallatit përbri. Këshilli Bashkiak ngarkon Komisionin e Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve ta shohë gjendjen në vend.
8. Familja Celiku ankohet për lejen për truall ndërtimi dhënë po nga nga qytetari i familjes Celiku. Këshilli Bashkiak ngarkon Komisionin e Zhvillimit Urban dhe Ndërtimeve ta shohë gjendjen në vend.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI